REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit 01/02 Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 456-10/2021
Nr. i fageve / Broj stranica / No. pages: Data / Datum / Date: 30/08/2021
Hyrëse PRISHTINË/A

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

***Qeveria –Vlada-Government***

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarsvo Finansija, Rada i Transfera – Ministry of Finance, Labour and Transfers*

**Nr. 17-2/2021**
**Data: 30.08.2021**

Në mbështetje të nenit 8, paragrafit 1.4 ndërlidhur me shtojcën 1, paragrafin 2.1 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në mbështetje të nenit 11, paragrafët 1.4, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, dhe në ndërlidhje të Vendimit Nr. 17/16, i datës 22.06.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Pika 1 e Vendimit Nr. 17/1/2021 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, të datës 29.06.2021, plotësohet dhe ndryshohet me tekstin si në vijim:

   1.1. Pezullohet deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër, obligimi i ri-aplikimit dhe reduktohen procedurat për njohjen e së drejtës për ndihmë sociale (ripërtëritja e dokumenteve, verifikimi i gjendjes socio-ekonomike dhe raporteve mjekësore) për familjet të cilat duke filluar nga muaji prill 2021 kanë afatin për ri-aplikim.

2. Pika 2 e Vendimit Nr. 17/1/2021 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, të datës 29.06.2021, plotësohet dhe ndryshohet me tekstin si në vijim:

   4. Ky vendim është i vlefshëm deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër, dhe mund të rishikohet duke pasur parasysh rekomandimet dhe/ose vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfshirë Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

3. Pikat e tjera të Vendimit Nr. 17/1/2021 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të datës 29.06.2021 mbesin të pandryshuara.

4. Ky vendim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Hekuran Murati

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Iu dërgohet:

- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Politikave Sociale dhe të Familjes;
- Departamentit të Pensioneve;
- Departamentit Ligjor; dhe
- Arkivit të Ministrisë.